



Republika e Kosovës
Republik of Kosova
Republika Kosovo



Komuna e Vitisë
Municipality of Vitina
Opstina Vitina

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Kosovës, nën 5 pikat d, nën 35 pikat 1 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-032, dhe të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.08/14, të datës 25.02.2014, për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorëve dhe të zv.drejtorëve të institucioneve edukativo - arsimore dhe aftësues, Drejtoria e Arsimit shpall:

KONKURS PUBLIK

(Rishpallje)

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në institucionet edukativo-arsimore

- Drejtor në Çerdhen e fëmijëve „**Gëzimi ynë**” – Viti.
- Drejtor në Shkollën Fillore „**28 Nëntori**” – Verban.
- Drejtor në Shkollën Fillore „**Mirali Sejdiu**” – Goshicë.
- Drejtor në Shkollën Fillore „**Dëshmorët e Lubishtës**” – Lubishtë.
- Drejtor në Shkollën Fillore „**Halil Alidema**” – Pozheran.

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët që konkurrojnë në këtë konkurs:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit, sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullat ivës tjetër ligjore.
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit.
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim.
- Të kenë më së paku 3 vjet përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit.

Të posedojnë këto dokumente:

- Çertifikatën e lindjes,
- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës,
- Dëshminë për përvojën e punës,
- Portofolin profesional (shih shtojcën G),

- Letër reference nga një institucion publik – kredibil (Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, DKA, këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë),
- Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprak,
- Planin zhvillimor të institucionit edukativo - arsimor dhe aftësues, për të cilin ka konkurruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave me 12, arial), sipas udhëzimit të MASHT,
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion shëndetësor publik, me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore,
- Dëshminë se nuk është nën hetime,
- Kopjen e letërnjoftimit.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegje private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këtë pozitë, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, në pajtim me Udhëzimin Administrative Nr.8/2010, të datës 22.06.2010. Në të kundërtën, komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve, të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet e konkursit.

Kandidatët e interesuar, aplikacionet i marrin dhe i dorëzojnë në Drejtorin Komunale të Arsimit në Viti.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Viti, më 11.11.2016

Drejtoria Komunale e Arsimit -Viti